

VENDIM
Nr. 201, datë 4.3.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SPORTIT TE MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR QENDRËN
RINORE KORÇË, TË KATIT TË PARË TË OBJEKTIT, ME EMËRTIM “ISH-SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2002, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Qendrën Rinore Korçë, të katit të parë të objektit, me emërtim “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, Korçë, për ta përdorur për mjedise pune për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë së funksionimit të këtij institucioni.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Qendra Rinore Korçë nuk mund ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë apo t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



KOMPANI PËRSHI SHKËRIMETI NR. 122 - 12 (Klasë - 12) E-mail: shkrimet@shkrimeti.com		FAZA PROJEKTI: PROJEKTI ZBATIM DOKUMENTI: STUDIUM - PROJEKTI MËSHTOJËSH I BASHKËPËRITËS DË VËNTIMARRËSVE NË KODIN	GRUPET I PROJEKTI (2017)	DR. ALI DEDË PAPAQOSHA		MIRATOHET	PLANIMETRI E KATIT PERDHE (EKZISTUESE)	A - 06
				DR. VETRI DEDËHODI				

